

20070240385

L I G J **PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTESIMIN E LIGJIT PËR KULTURE**

Neni 1

Në Ligjin për kulturë ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonise" numer 31/98, 49/2003 dhe 82/2005), në nenin 11 pas paragrafit (3) shtohet paragraf i ri (4) si vijon:

"Keshilli për kulturë si organ profesional dhe keshilledhenes i jep mendim ministrit të Kultures për ndarjen e titullit Ambasador i Kultures i Republikës së Maqedonise."

Neni 2

Pas nenit 11 shtohet nen i ri 11-a si vijon:

"Neni 11-a

(1) Qeveria e Republikës së Maqedonise, me propozimin e ministrit të Kultures, personaliteteve të dalluara dhe të afirmuara nga lemi i kultures, që janë shtetas të Republikës së Maqedonise dhe të cilet me veprimin e vet jashtë vendit kontribuojnë dukshëm për prezantimin e kultures së Republikës së Maqedonise në bote, iu ndane titullin Ambasador i Kultures i Republikës së Maqedonise, me pajtimin e tyre.

(2) Qeveria e Republikës së Maqedonise fituesve të titullit Ambasador i Kultures i Republikës së Maqedonise në menyre solemne iu ndane pllakete. Titulli Ambasador i Kultures i Republikës së Maqedonise është titull nderi dhe pa kompensim me para.

(3) Pllaketa që u ndahet pjesetareve të bashkësisë etnike e cila është mbi 20% në Republikën e Maqedonise, përveç në gjuhën maqedonishte ndahet edhe në gjuhën të cilën e flet pjesëtari i asaj bashkësie.

(4) Për aktivitet e ambasadoreve të kultures, në se nevojitet mjete financiare për promovimin e kultures së Republikës së Maqedonise do të sigurohen në pajtim dhe në bashkëpunim me ambasadën perkatese të Republikës së Maqedonise ose me institucionin nacional të kultures nepermjet programeve të tyre për bashkëpunim kulturor nderkombëtar dhe nga mjetet e parapara në Buxhetin e Republikës së Maqedonise për këtë dedikim, në vitin në vijim."

Neni 3

Nentitulli "1.2. Veprimtaria muzikore dhe skenike-artistike" dhe neni 51 ndryshojnë si vijojnë:

"1.2. Veprimtaria muzikore

Neni 51

(1) Veprimtari muzikore, në kuptim të këtij ligji, është përgatitja dhe ekzekutimi publik i veprave muzikore.

(2) Emri i institucionit ose i personit tjetër juridik që kryen veprimtari muzikore janë filarmونيا, orkestra simfonike ose orkester tjetër dhe ngjashëm".

Neni 4

Pas nenit 51 shtohet nentitull i ri shtohet nentitull 1.2.-a dhe neni 51-a s'vijojnë:

"1.2.-a. Veprimtaria skenike-artistike

Neni 51-a

(1) Veprimtari skenike-artistike në kuptim të këtij ligji, është përgatitja dhe ekzekutimi publik i veprave artistike dramatike, të operës, operetës, të baletit, vallezimeve, të kukullave dhe të veprave tjera artistike, kengeve dhe valleve popullore, si dhe të veprave të folklorit.

(2) Emri i institucionit ose personit tjetër juridik që kryen veprimtari skenike-artistike është opera, kori, teatri, drama, baleti, ansambli i kengeve dhe valleve popullore, ansambli i vallezeimit dhe ngjashëm.”

Neni 5

Titulli i Kapitullit "Dispozita ndeshkuese" zëvendësohet me titullin “Sanksione për kundërvajtje”.

Në nenin 91 paragrafi (1) fjalet: "Denim me para prej 10.000 deri 300.000 denare do të denohet për kundërvajtje personi juridik që" zëvendësohen me fjalet: "Gjohet në shumë prej 2.500 deri 5.000 euro me kundërvlerë në denare për kundërvajtje të personit juridik që”.

Në paragrafin (2) fjalet: "Denim me para prej 1.000 deri 50.000 denare do të denohet për kundërvajtje" zëvendësohen me fjalet: "Gjohet në shumë prej 1.000 deri 2.000 euro me kundërvlerë në denare do t'i kumtohet për kundërvajtje edhe”.

Në paragrafin (3) fjalet: "Denim me para prej 1.000 deri 50.000 denare do të denohet edhe" zëvendësohen me fjalet: "Gjohet në shumë prej 1.000 deri 2.000 euro me kundërvlerë në denare do t'i kumtohet edhe”.

Paragrafi (4) ndryshon si vijon:

"Për kundërvajtjen e paragrafit (1) të këtij neni mund të kumtohet edhe ndalim i kryerjes së profesionit, veprimtarisë ose detyrës në kohezgjatje prej një deri tri vjet.”

Neni 6

Ky ligj hyn në fuqi ditën e tetë nga dita e shpalljes në "Gazetën zyrtare të Republikës së Maqedonisë”.